



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republik of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA

31-05-2023

Prirja - Përfaqësues	Numri/Drej	Shprehja	Vlera
Ordhëri		Prilog	Vendimet

02-110/05 756



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.1 dhe paragrafi 12.2 shkronja d, neni 40.2 shkronja c të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenin 2 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-49 i ndryshuar dhe plotësuar nga Ligji Nr.05/L-108 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, bazuar në Ligjin Nr. 08/L-193 – mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, neni 9 - të ndarja dhe rindarja e fondeve të bartura si dhe obligimet e pakryera financiare nga viti paraprak, pika 1.2, dhe pika 6, bilancet e pashpenzuara të të hyarve vetanake të komunave, neni 36, paragrafi 36.2 shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më datën 30.05.2023, merr këtë:

## V E N D I M

**për bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake të vitit 2022 në vitin 2023**

### Neni 1

Me këtë Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin për bartjen e Buxhetit Komunal nga të hyrat vetanake të pashpenzuara të vitit 2022 në vitin 2023. Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-193 – mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, neni 9 - te ndarja dhe rindarja e fondeve të bartura si dhe obligimet e pakryera financiare nga viti paraprak, pika 1.2, dhe pika 6, bilancet e pashpenzuara të të hyarve vetanake të komunave për bartjen e Buxhetit Komunal në vlerë prej **312,040.38 €** të vitit 2022 në vitin 2023.

### Neni 2

Bartja e Buxhetit komunal nga të hyrat vetanake komunale propozohen të shpërndahen në këto kategori ekonomike :

1. Mallëra e shërbime në shumë prej	108,132.01 €
2. Subvencione e transfere në shumë prej	121,077.73 €
3. Investime kapitale në shumë prej	82,830.64 €

**Të shpërndara në këto nën programe buxhetore:**

**Në kategorinë ekonomike mallëra dhe shërbime shuma prej 108,132.01 €, në nën-programet:**

- Infrastruktura publike (18193), shuma prej ..... 102,064.01 €.
- Shërbimet e shëndetësisë primare (74950), shuma prej .....5,729.30 €.
- Administrata (92165), shuma prej .....338.70 €.

**Në kategorinë ekonomike subvencione dhe transfere, shuma prej 121,077.73 €, në nën programet:**

- Zyra e Kryetarit (16033), shuma prej ..... 50,711.00 €.
- Bujqësia (47033), shuma prej .....39,186.73 €
- Shërbimet kulturore (85033), shuma prej ..... 7,660.00 €.
- Shërbimet sociale - Viti (75661), shuma prej 23,520.00 €.

**Në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale, shuma prej 82,830.64 €, në nën programin:**

**Buxheti (17533), shuma prej 80,230.64 € në projektet:**

- Participim i projekteve me donatorë, kod (90552), shuma prej ... 11,073.03 €
- Rregullimi i fushave sportive, kod (44152), shuma prej ..... 69,157.61 €

**Shërbimet e shëndetësisë primare (74950), shuma prej 2,600.00 €, në projektin:**

- Renovimi i ambulants në Viti kod (53893) shuma prej në shumë prej 2,600.00 €.

**Arsyetim:**

Në kërkesën për bartje të mjeteve të pashpenzuara nga të hyrat vetanake të vitit 2022 në vitin 2023 nuk ka ndryshim në strukturën e shpenzimeve.

Komuna ka tejkeluar planin e të hyrave vetanake të vitit 2022 në vlerë prej 195,500.14 euro, (në vlerë prej 98,404.67 € janë rritur mallrat e shërbimet, bartja bëhet për arsye të pagesës së obligimeve ndaj operatorëve ekonomik në sektorin e shërbimeve publike, bartja në vlerë prej 50.000.00 janë rritur subvencionet dhe transferet, bartja bëhet për pagesën e bursave të studentëve, ndërsa pjesa tjetër në vlerë prej 47,095.47 € janë rritur shpenzime kapitale në projektin “Rregullimi i fushave sportive”.

Bartja e të hyrave në vlerë 108,132.01 €, në mallra dhe shërbime bëhet për arsye të pagesës së obligimeve ndaj operatorëve ekonomik në sektorin e shërbimeve publike, bartja e të hyrave në kategorinë e shpenzimeve subvencione dhe transfere në vlerë 121,077.73 € bëhet për pagesën e bursave të studentëve, subvencioneve të bujqësisë, subvencioneve të kulturës dhe pjesa tjetër subvencionet e shërbimeve sociale, ndërsa bartja e të hyrave në kategorinë e shpenzimeve kapitale në vlerë prej 82,830.64 €, në projektet: Participim i projekteve me donatorë (mbulohet nga mbetja e mjeteve të projekteve të përfunduara), Rregullimi i fushave sportive dhe Renovimi i ambulants në Viti bëhet për mbulimin e planit të shpenzimeve të këtyre projekteve kapitale.

**Neni 3**

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset kryetari dhe Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim e Komunës së Vitisë.

**Neni 4**

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 8 lidhur me nenin 9 të Rregullores Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi ju dorëzohet:

1. Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim;
2. Zyrës së Kryetarit;
3. Shërbimit të Kuvendit; dhe
4. Arkivit.

**KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË**  
**KRYESUESI**

Bekim Azizi

